



Dalës-Izlazës

Nr. 11-341
Br.

Data 12.04.2022
Datum

REPUBLICA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 59 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, me datë 12.04.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit: “ **Furnizim me pemë dhe perime**”, me nr. te prokurimit: 614-22- 004- 121, në këtë përbërje:
 1. Elfete Gërguri – kryesuese
 2. Fatime Pllana – anëtare
 3. Mema Mjeku – anëtare
- II. Anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë siç janë specifikuar për anëtarët e stafit të Divizionit të Prokurimit në nenin 23.3 të LPP-së, dhe do të nënshkruajnë deklaratën me shkrim dhe i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.
- III. Komisioni do të funksionoj nga dita e miratimit të vendimit për krijimin e komisionit deri në përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.
- IV. Komisioni në fund të detyrës së tij, do të përgatit një rekomandim për Zyrtarin e Prokurimit së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklaratë të arsyeve mbështetëse për rekomandim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Te dorëzohet:

- Anëtareve te Komisionit,
- Zyrës së Prokurimit
- Arkivit

